



Strasbourg, 6.2.2018  
COM(2018) 65 final

**KOMUNIKATA NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN,  
KËSHILLIN, KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN DHE  
KOMITETIN E RAJONEVE**

**Perspektiva kredibile e zgjerimit dhe angazhimi i shtuar i BE-së me Ballkanin  
Perëndimor**

## PERSPEKTIVA KREDIBILE E ZGJERIMIT DHE ANGAZHIMI I SHTUAR I BE-SË ME BALLKANIN PERËNDIMOR

Në fjalimin e tij për **Gjendjen e Unionit 2017**, President i Komisionit Evropian Jean-Claude Juncker riafirmoi të ardhmen evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor:

*"Nëse duam më tepër stabilitet në fqinjësinë tonë, atëherë duhet ta ruajmë një perspektivë të besueshme për Ballkanin Perëndimor. Është e qartë që nuk do të ketë zgjerim të mëtejme gjatë mandatit të këtij Komisioni dhe këtij Parlamenti. Asnjëri kandidat nuk është gati. Por më pas Bashkimi Evropian do të jetë më i madh se 27 në numër. Kandidatët për aderim duhet t'i japin përparësinë më të madhe sundimit të ligjit, drejtësisë dhe të drejtave themelore gjatë negociatave."*

Krerët e shtetit dhe qeverisë së BE-së e kanë mbështetur në vazhdimësi rrugën evropiane të rajonit, rishtazi në konkluzat e Presidentit të Këshillit Evropian në mars të vitit 2017:

*"Këshilli Evropian [...] e riafirmoi mbështetjen e tij të qartë për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Duke mirëpritur progresin e bërë nga vendet e rajonit, Këshilli Evropian thekson që BE-ja mbetet e angazhuar dhe e përkushtuar në të gjitha nivelet për t'i mbështetur ato në realizimin e reformave dhe projekteve të orientuara kah BE-ja."*

Ballkani Perëndimor është **pjesë e Evropës**, gjeografikisht i rrethuar nga shtete anëtare të BE-së. Popujt e BE-së dhe të rajonit kanë trashëgimi dhe histori të përbashkët dhe një histori që përkufizohet nga mundësi dhe sfida të përbashkëta. BE-ja është fuqimisht e angazhuar në rajon për një kohë të gjatë. Që nga Këshilli Evropian i Selanikut më 2003, ai e ka mbështetur të ardhmen e rajonit si pjesë përbërëse e BE-së.

Që atëherë, perspektiva evropiane e rajonit u ka ndihmuar vendeve të realizojnë reforma të përgjithshme politike dhe ekonomike me procese të përmirësuara demokratike. Liberalizimi i vizave dhe bashkëpunimi i përmirësuar rajonal po çojnë në krijimin e shoqërive më të hapura. Në vitin 2016, tregtia e përgjithshme e rajonit me BE-në ishte mbi 43 miliardë euro, që përfaqëson një rritje prej 80% që nga viti 2008 dhe me potencial të konsiderueshëm për rritje të mëtejme. Kompanitë e BE-së gjithashtu janë investitorët më të mëdhenj në Ballkanin Perëndimor, me mbi 10 miliardë euro investime të huaja direkte në rajon vetëm në pesë vitet e fundit. Ndërlidhja dhe ndërvarësia e rajonit me Bashkimin Evropian ishte e dukshme në krizën e migrimit. Vendet e rajonit gjithnjë e më tepër po veprojnë si partnerë në rrafshin global.

Kjo perspektivë e fuqishme, e bazuar në merita, e anëtarësimit në BE për Ballkanin Perëndimor është në vetë **interesin politik, të sigurisë dhe ekonomik** të Bashkimit Evropian. Kjo është një investim gjeostrategjik në një Evropë stabile, të fuqishme dhe të njëzuar të bazuar në **vlera të përbashkëta**. Ajo përbën një mjet të fuqishëm për të promovuar demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave themelore. Perspektiva e besueshme e aderimit është **shtytësi kryesor i transformimit** në rajon, kështuqë ajo përmirëson integrimin, sigurinë, prosperitetin dhe mirëqenien tonë sociale kolektive. Ajo mbetet thelbësore për nxitjen e pajtimit dhe stabilitetit.

Për më tepër, politika e zgjerimit e BE-së duhet të jetë pjesë përbërëse e strategjisë më të gjerë për fuqizimin e Unionit deri më 2025, të përcaktuar nga Presidenti Juncker në fjalimin e tij

për Gjendjen e Unionit në shtator 2017. Ajo përbën **një investim në sigurinë, rritjen ekonomike dhe influencën e BE-së**, si dhe në aftësinë e tij për t'i mbrojtur qytetarët e vet.

Megjithatë, **Unioni ynë duhet të jetë më i fuqishëm dhe më solid para se të mund të bëhet më i madh**. Kjo është arsyeja pse, në pajtim me Udhërrëfyesin për një Union më të Bashkuar, më të Fortë dhe më Demokratik<sup>1</sup>, Komisioni gjatë këtij viti do të ndërmarrë një numër iniciativash me qëllim të përmirësimit të kornizës demokratike, institucionale dhe politike për Unionin e vitit 2025, bazuar në traktatet aktuale. Në veçanti, këto iniciativa do të përfshijnë propozime për të përmirësuar efektivitetin e vendimmarrjes në kuadër të BE-së duke përmirësuar votimin e shumicës së kualifikuar në fusha si politika e jashtme ose çështjet e tregut të brendshëm.

**Deri në atë datë, BE-ja mund të ketë mbi 27 anëtarë.** Negociatat e aderimit tashmë janë në proces e sipër me Malin e Zi dhe Serbinë. Me një vullnet të fortë politik, realizim të reformave reale dhe të qëndrueshme, si dhe zgjidhje përfundimtare të kontesteve me vendet fqinje, ato mund të jenë potencialisht të gatshme për anëtarësim në perspektivën e 2025-ës. Kjo perspektivë është jashtëzakonisht ambicioze. Se a do të realizohet ajo do të varet plotësisht në meritat dhe rezultatet objektive të secilit vend.

Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor tani duhet urgjentisht të ridyfishojnë përpjekjet e tyre, të adresojnë reformat jetike dhe të përfundojnë transformimin e tyre politik, ekonomik dhe social, duke bërë bashkë të gjitha palët e interesit nga i gjithë spektri politik dhe nga shoqëria civile. Anëtarësimi në BE është shumë më tepër se një proces teknik. Ai është një zgjedhje kolektive, bazuar në vlera themelore, të cilën vendet duhet ta përqafojnë më aktivisht, duke filluar nga politikat e tyre të jashtme dhe rajonale e deri te ajo që u mësohet fëmijëve në shkollë.

Vendet e Ballkanit Perëndimor tani kanë një **dritare historike të mundësisë** për ta lidhur të ardhmen e tyre në mënyrë të vendosur dhe të qartë me Bashkimin Evropian. Ato do të duhet të veprojnë me vendosmëri. Anëtarësimi është dhe do të mbetet një proces i bazuar në merita, i cili varet plotësisht nga progresi objektiv i arritur nga secili vend. Vendet mund të arrijnë ose të tejkalojnë njëri-tjetrin në varësi të progresit të bërë.

Komisioni është i gatshëm të përgatisë rekomandime për të hapur negociatat e aderimit me Shqipërinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në bazë të kushteve të përmbushura. Me përpjekje dhe angazhim të qëndrueshëm, Bosnja dhe Hercegovina mund të bëhet kandidat për aderim. Kosova\* ka një mundësi për progres të qëndrueshëm nëpërmjet implementimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe për të përparuar në rrugën e saj evropiane kur këtë ta lejojnë rrethanat objektive.

Jeta e përditshme në Ballkanin Perëndimor duhet gradualisht t'i përafrohet jetës në Bashkimin Evropian. Në fund të fundit, qytetarët dëshirojnë të jetojnë në vende të begata dhe të barabarta, ku sundimi i ligjit është i fortë dhe korrupsioni është i çrrënjësuar. Kjo Strategji përcakton se si me rritjen e mbështetjes nga BE-ja, duke përfshirë edhe përmes pjesëmarrjes në politika dhe programe të caktuara të Unionit, vendet e Ballkanit Perëndimor tashmë mund

---

<sup>1</sup> [https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/roadmap-factsheet-tallinn\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/roadmap-factsheet-tallinn_en.pdf)

\* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

të përfitojnë nga një stabilitet dhe prosperitet më i madh që do të lehtësojë përparimin në rrugën e tyre evropiane.

## **I. NJË PERSPEKTIVË KREDIBILE E ZGJERIMIT KËRKON PËRËPJEKJE DHE REFORMA KREDIBILE NË BALLKANIN PERËNDIMOR<sup>2</sup>**

Vendet e Ballkanit Perëndimor **do të jenë në gjendje të hyjnë në Bashkimin Evropian** kur të përmbushen kriteret e nenit 49 të Traktatit për Bashkimin Evropian, duke përfshirë kriteret e Kopenhagës. Derisa **asnjëri nuk i plotëson këto kritere sot**, rajoni ka bërë një rrugë të gjatë që nga fundi i viteve të 1990-ta. Në përgjithësi, është bërë përparim i dukshëm si në aspektin e reformave, ashtu edhe në kapërcimin e trashëgimisë shkatërruese të luftës dhe konfliktit. Por, në mënyrë që vendet **të përmbushin të gjitha kushtet e anëtarësimit dhe të forcojnë demokracitë e tyre, ende nevojiten reforma gjithëpërfshirëse dhe bindëse në fusha vendimtare**, veçanërisht në sundimin e ligjit, konkurrencën dhe bashkëpunimin dhe pajtimin rajonal.

Së pari, **sundimi i ligjit** duhet të rritet ndjeshëm. Sot, vendet tregojnë elemente të qarta të kapjes së shtetit, duke përfshirë lidhjet me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës, si dhe një ngatërrim të fortë të interesave publike dhe private. E gjithë kjo ushqen një ndjenjë të mosndëshkimit dhe pabarazisë. Ka gjithashtu ndërhyrje të gjera politike dhe kontroll të mediave. Sistemi gjyqësor i fuqizuar dhe i pavarur, si dhe qeveritë dhe administratat e përgjegjshme, janë thelbësore për të sjellë ndryshimet e qëndrueshme shoqërore që nevojiten.

Së dyti, pjesë kritike të **ekonomive të rajonit** janë jokonkurrese, me shumë ndërhyrje të panevojshme politike dhe një sektor privat të pazhvilluar. Asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor aktualisht nuk mund të konsiderohet si një ekonomi tregu funksionale dhe as që ka kapacitetin për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut në Union. Përkundër tërë progresit të bërë në reforma, mbeten shumë çështje strukturore, të cilat ndikojnë në tregjet e punës dhe veçanërisht në mundësitë e punësimit për të rinjtë.

Së treti, ende ekzistojnë **konteste të rëndësishme bilaterale** midis vendeve të rajonit të cilat mbeten për t'u zgjidhur. BE-ja nuk do të pranojë t'i importojë këto mosmarrëveshje dhe paqëndrueshmërinë që mund të sjellin ato. Duhet të gjenden dhe zbatohen zgjidhje përfundimtare dhe detyimore përpara se një vend të aderojë.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, **anëtarësimi në BE është një zgjedhje**. Për të nevojitet konsensus politik dhe shoqëror dhe mbështetje nga zemra dhe mendja e njerëzve. Nuk duhet të ketë paqartësi nga udhëheqësit rreth asaj se ku e ka vendin Ballkani Perëndimor dhe drejtimin që ai ka marrë. Kjo është e domosdoshme për të siguruar dhe ruajtur mbështetjen e qytetarëve të tyre dhe të qytetarëve të BE-së, si dhe duhet të pasqyrohet në komunikimin dhe kontaktin e udhëheqësve me qytetarët.

Rrugët përkatëse evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor janë të lidhura me iniciativa të ndryshme, si Procesi i Berlinit<sup>3</sup>, platformat sektoriale siç janë Komunitetet e Energjisë dhe Transportit dhe akterët rajonalë, siç është Këshilli për Bashkëpunim Rajonal.

---

<sup>2</sup>Komisioni do të miratojë komunikimin e tij të rregullt mbi politikën e zgjerimit të BE-së bashkë me raportet gjithëpërfshirëse të vendeve në prill 2018.

Tani është në dorën e autoriteteve të vendeve, me mbështetjen e shoqërive të tyre, të marrin përgjegjësi dhe të përmbushin kushtet e mirënjohura për aderim. Për ta bërë realitet skenarin më të mirë ambicioz, **duhet të ndërmerren veprime tani**. Në fund të fundit, qytetarët e rajonit do të gjykojnë qeveritë e tyre nëse janë apo nuk janë të gatshëm dhe të aftë për të përmbushur ambiciet e tyre evropiane.

## 1. Sundimi i ligjit, të drejtat themelore, qeverisja

Adresimi i reformave në fushën e **sundimit të ligjit, të drejtave themelore dhe qeverisjes së mirë** mbetet çështja më e ngutshme për Ballkanin Perëndimor. Është gjithashtu pika kryesore referuese karshi së cilës do të gjykojnë perspektivat e këtyre vendeve nga BE-ja. Rajoni duhet t'i përqafojë këto vlera themelore të BE-së shumë më fuqishëm dhe më besueshëm. Mosrespektimi i tyre është gjithashtu një pengesë për investimet dhe tregtinë. Forcimi i sundimit të ligjit nuk është vetëm një çështje institucionale. Ai kërkon transformim shoqëror.

Duhet të sigurohet **pavarësia, cilësia dhe efikasiteti** i sistemit gjyqësor. Pavarësia e gjyqësorit dhe e gjyqtarëve individualë është thelbësore për të siguruar drejtësi dhe për t'i mbajtur ekzekutivin dhe legjislativin e qeverisë përgjegjës. Ky është parakusht për çdo shoqëri demokratike të bazuar në sundimin e ligjit dhe për zhvillimin e saj ekonomik.

Vendet duhet ta **çrrënjosin** korrupsionin pa kompromis. Institucionet e fuqishme dhe të pavarura janë vendimtare për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin dhe për të kryer hetime dhe persekutime më efektive, duke çuar në vendime të plotfuqishme të gjykatave, **që zbatohen** dhe përfshijnë **sanksione bindëse**. Strukturat e specializuara prokuroriale për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe organet gjyqësore duhet të fuqizohen ndjeshëm. Kjo duhet të përfshijë caktimin e njësisve speciale të policisë nëpër prokurori. Duhet të ndiqen dhe të zbatohen masa të tilla si heqja e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, humbja e të drejtës për të mbajtur postin publik, rregulla më të rrepta të pajtueshmërisë për zyrtarët publikë dhe informata të kapshme dhe mekanizmat e ankesave për qytetarët.

Vendet gjithashtu duhet të vendosin një kornizë të fortë për parandalimin e korrupsionit. Nevojitet më shumë transparencë në menaxhimin e fondeve publike sidomos në të gjitha fazat e **prokurimit publik**, një fushë veçanërisht e ndjeshme ndaj korrupsionit. Ka pasur disa shembuj në Ballkanin Perëndimor të procedurave konfidenciale për prokurimin e mallrave dhe disa kontrata të mëdha janë dhënë pa tender publik. Ka pasur pretendime për favorizim të nënkontraktorëve lokalë të lidhur politikisht dhe pagesa të paligjshme. Vendet duhet të rrisin ndjeshëm transparencën, konkurrencën dhe drejtësinë e tenderëve të prokurimeve publike, të kufizojnë përdorimin e procedurave konfidenciale dhe të vendosin masa mbrojtëse, duke përjashtuar ndikimin politik mbi ofertuesit. Përdorimi i **prokurimit elektronik** transparent, të qasshëm për publikun, duhet të shtrihet plotësisht. Kjo duhet t'u mundësojë qytetarëve të shohin qartë se si shpenzohen taksat e tyre, që nga tenderi fillestar deri në ekzekutimin përfundimtar të kontratave. Llogaridhënia menaxheriale dhe kultura e kontrollit të brendshëm në institucionet publike janë gjithashtu vendimtare.

Pikëmbështetja e **krimin të organizuar** në Ballkanin Perëndimor mbetet e fortë, qoftë në aspektin e trafikimit të qenieve njerëzore, të drogës dhe të armëve, ose rrezikut të infiltrimit kriminal të sistemeve politike dhe ekonomike. Autoritetet duhet të **shpërbëjnë rrjetet kriminale dhe bazat e tyre ekonomike** në mënyrë më efektive, duke shfrytëzuar

---

<sup>3</sup>Samiti i fundit i procesit u mbajt në Trieste në korrik 2017.

sistematikisht hetimet financiare dhe duke aplikuar **mjete më të fokusuara** si ngrirja parandaluese e të ardhurave kriminale, konfiskimi i palës së tretë, barra e kundërt e provës për mbajtjen e llojeve të caktuara të pasurive, konfiskimi pa aktgjykim për të trajtuar pasurinë e pashpjegueshme, kërkesat për zbulimin e plotë të pronësisë për kompanitë, si dhe bashkëpunimi i zgjeruar gjyqësor. Evidentimi **konkret i qëndrueshëm në luftimin e korrupsionit korrupsionit, shpëlarjes së parave dhe krimit të organizuar** duhet të bëhet sa më parë.

**Të drejtat themelore** janë kryesisht të përfshira në legjislacionin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, por duhet bërë më shumë për të siguruar që ato të zbatohen plotësisht në praktikë. Theks i veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe pavarësisë së medias si shtyllë e demokracisë. Nevojiten përpjekje vendimtare për të mbrojtur minoritetet dhe për të luftuar diskriminimin, sidomos kundër romëve - për të cilët përfshirja sociale duhet të promovohet më fuqishëm - dhe komunitetit LGBTI. Duhet gjithashtu të sigurohet barazia mes grave dhe burrave dhe të trajtohet dhuna në familje.

Fuqizimi i funksionimit të **institucioneve demokratike** është thelbësor. Kjo përfshin sigurimin e dialogut konstruktiv në të gjithë spektrin politik, posaçërisht brenda **parlamenteve**. Qeveria duhet të sigurojë që opozita të ketë mundësinë të kryejë plotësisht rolin e saj. Ndërsa opozita duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive në procesin demokratik. Zgjedhjet duhet të jenë të lira dhe të drejta dhe rekomandimet e misionëve të vëzhgimit të zgjedhjeve të zbatohen siç duhet. Rregullat për **financimin publik dhe privat të partive politike** gjithashtu kërkojnë reforma thelbësore.

**Reforma e administratës publike** është thelbësore për forcimin e qeverisjes në të gjitha nivelet. Kjo përfshin përmirësimin e cilësisë dhe llogaridhënies së administratës, rritjen e profesionalizmit, depolitizimit dhe transparencës, duke përfshirë edhe në rekrutime dhe shkarkime, menaxhimin më transparent të financave publike dhe shërbime më të mira për qytetarët. Duhet gjithashtu të gjendet një ekuilibër i përshtatshëm midis qeverisë qendrore, rajonale dhe lokale.

Qeveritë duhet të sigurojnë që palët e interesuara mund të marrin pjesë aktive në procesin e reformimit dhe politikëbërjes, për shembull, me anë të **dialogut gjithëpërfshirës të strukturuar mbi prioritetet e reformës** me përfshirjen e një shoqërie civile të fuqizuar. Për këtë arsye, një mjedis i përshtatshëm për organizatat e shoqërisë civile është vendimtar.

Të gjitha këto reforma mbeten në thelb të rrugës së rajonit në BE. Vetëm me arritjen e rezultateve të prekshme dhe të qëndrueshme do të arrihet momentum i kredibil i nevojshëm.

## 2. Forcimi i ekonomisë

Rajoni i Ballkanit Perëndimor ka **potencial ekonomik** të rëndësishëm. Normat e rritjes janë më të larta se ato të BE-së dhe është një treg gjithnjë e më interesant për mallrat dhe shërbimet e BE-së, që po bëhet gradualisht pjesë e zinxhirëve evropianë të vlerës. Niveli i integritimit ekonomik me Unionin tashmë është shumë i lartë, për shkak të Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit.

Megjithatë, nevojiten **përpjekje të mëtejshme** për të rritur konkurrueshmërinë e ekonomive të Ballkanit Perëndimor, për të trajtuar papunësinë e lartë, sidomos në mesin e të rinjve, për të rritur prosperitetin dhe për të krijuar mundësi biznesi jo më të pakta për akterët lokalë.

Ekonomitë më të forta të bazuara në shkathhtësi gjithashtu do të ndihmojnë në zvogëlimin e ikjes ekzistuese të fuqisë së kualifikuar punëtore dhe në zëvendësimin e ikjes me qarkullim. Modernizimi i mëtutjeshëm i ekonomive rajonale do të tërheqë më tej investimet private të BE-së dhe do të rrisë kërkesën për mallra dhe shërbime të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Reformat e nevojshme strukturore duhet të mbështeten nga politikat e duhura ekonomike dhe fiskale.

Ekonomitë e rajonit përballen me shumë **dobësi strukturore**, me tregje joefikase dhe të ngurtë, me produktivitet të ulët, me qasje të kufizuar në financa, me të drejta të paqarta mbi pronësinë dhe me një mjedis të vështirë rregullativ, duke çuar në konkurrencë të ulët dhe papunësi të lartë. Në përgjithësi, nivelet e investimeve dhe normat e rritjes janë të pamjaftueshme për të reduktuar dukshëm hendekun me BE-në. Zhvillimi ekonomik pengohet më tej nga ekonomia e shtrirë gri. Përfshirja e shtetit dhe ndërhyrja e panevojshme politike në ekonomi mbeten të larta, ndërkohë që politika e konkurrencës dhe politikat e tjera mbështetëse ende janë shumë të dobëta. Reformat strukturore të përvijuara në Programet e Reformës Ekonomike duhet të ndiqen me më shumë rigorozitet. Masat që merren me sfidat sociale dhe papunësinë strukturore duhet të priorizohen. Proceset e privatizimit duhet të avancohen me transparencë të plotë. Ndërmarrjet shtetërore duhet të reformohen si një prioritet dhe të trajtohet korrupsioni. Potenciali i rritjes dhe konkurrenca vazhdojnë të pengohen nga dobësitë në sundimin e ligjit dhe funksionimin e dobët të institucioneve.

Integrimi i suksesshëm ekonomik brenda rajonit dhe në BE do të jetë i mundur vetëm me shtimin e **lidhshmërisë**. Një numër shumë i madh i detyrimeve nga marrëveshjet rajonale ende nuk janë plotësuar. Vendet duhet ta respektojnë plotësisht Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe Traktatin e Komunitetit të Transportit dhe rregullat përkatëse të BE-së për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, me anë të të cilave ata janë zotuar të miratojnë *acquis*-in e energjisë dhe transportit, si dhe standardet e ndërlidhura (p.sh., mjedisi dhe konkurrenca) para aderimit.

Rajoni gjithashtu duhet të sigurojë që marrëveshjet dhe angazhimet ekzistuese të bëhen funksionale, për shembull në kontekstin e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lrë, e cila duhet të reformohet për të adresuar më mirë nevojat e rajonit. Miratimi i një Plani Shumëvjeçar të Veprimit për zhvillimin e një zone ekonomike rajonale, të dakorduar nga udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor në korrik 2017, është premtuese: zbatimi i tij do të forcojë më tej tregtinë, investimet dhe lëvizshmërinë brenda rajonit dhe midis rajonit dhe BE-së. Kjo do të ndihmojë integrimin e tregjeve në zinxhirët evropiane dhe globale të vlerës dhe do të nxisë dixhitalizimin e ekonomive të rajonit. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në përshpejtimin e zhvillimit të ndërmarrjeve dhe aftësive, hulumtimit dhe inovacionit dhe rritjes së mençur.

### **3. Zbatimi i rregullave dhe standardeve të BE-së**

Çështjet thelbësore si sundimi i ligjit, të drejtat themelore, forcimi i institucioneve demokratike, reforma e administratës publike, si dhe zhvillimi ekonomik dhe konkurrenca mbeten prioritet kryesorë në procesin e zgjerimit. Ato formojnë bazën që çdo shtet anëtar aspirues të sigurojë se ka kapacitetet e nevojshme administrative dhe gjyqësore për të zbatuar siç duhet rregullat dhe standardet e BE-së jo vetëm në ligj, por edhe në praktikë. Shumë mbetet për t'u bërë në të gjitha fushat për t'u harmonizuar me *acquis*-in e BE-së, për të krijuar ose ndërtuar institucionet përkatëse dhe për të siguruar kapacitetet zbatuese, qoftë në aspektin e rregullave të tregut të vetëm, politikës sociale, energjisë dhe transportit, ose ligjit të BE-së për mjedisin.

Zbatimi i detyrimeve që burojnë nga Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit dhe marrëveshjet e tjera sektoriale do të mbështesin përgatitjet për përmbushjen e kërkesave të anëtarësimit në BE. Duhet të shfrytëzohet plotësisht asistenca teknike e konsiderueshme e disponueshme në mbështetje të veçantë për ndërtimin e institucioneve nëpërmjet Instrumentit të Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit.

#### 4. Pajtimi, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal - parakushte për aderim

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore janë thelbësore për përparim në rrugët evropiane të vendeve përkatëse. Krahas iniciativave rajonale ekzistuese, siç është Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, format e bashkëpunimit politik deri në nivelin më të lartë të nxitur nga rajoni dhe samitet e fundit kanë prodhuar një moment të ri. Ky moment duhet të shfrytëzohet më tej në mënyrë që të vazhdojë të kontribuojë në stabilizimin politik dhe të krijojë mundësi ekonomike.

Bashkë me përmirësimin e bashkëpunimit rajonal, përpjekjet e mëtejshme drejt pajtimit janë thelbësore për të vendosur fuqishëm paqen dhe për të siguruar stabilitet të qëndrueshëm në rajon. Nevojitet ende kohë për t'u shëruar plagët e viteve të 1990-ta. Por tani, pas 25 vjetësh, është koha e duhur për t'i trajtuar çështjet e hapura me energji të re. Të gjitha vendet duhet të angazhohen pa rezerva, si në fjalë ashtu edhe në veprë, për **tejkalimin e trashëgimisë** nga e kaluara, duke arritur pajtimin dhe duke zgjidhur çështjet e hapura shumë përpara aderimit të tyre në BE.

Bashkëpunimi rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe pajtimi nuk mund të imponohen nga jashtë. Udhëheqësit e rajonit **duhet të marrin përgjegjësinë e plotë** dhe duhet të jenë shembull për të tjerët. Ata duhet të shmangin dhe të dënojnë çdo deklaratë ose veprim që do të nxisnin tension ndëretnik dhe duhet të kundërshtojnë në mënyrë aktive narrativat nacionaliste. Nuk ka vend në BE për retorikë nxitëse, e aq më pak për lavdërimin e kriminelëve të luftës nga cilado palë. Procesi i **drejtësisë tranzicionale** është jo i plotë. Çështjet e ndjeshme të pazgjidhura, të tilla si trajtimi i rasteve të krimeve të luftës, duke përfshirë bashkëpunimin e plotë me Mekanizmin për Tribunalet Penale Ndërkombëtare dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës, fati i personave të zhdukur, refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, si dhe identifikimi dhe largimi i minave tokësore në rajon duhet të trajtohen urgjentisht.

Rolit të **arsimimit** duhet t'i jepet prioritet më i lartë, veçanërisht në drejtim të nxitjes së një tolerance më të madhe, promovimit të vlerave evropiane dhe forcimit të kohezionit të shoqërisë. Ballkani Perëndimor duhet të investojë më shumë në brezin e tij të ri, qytetarët tanë të ardhshëm të BE-së, dhe duhet t'u japë atyre një perspektivë për të ardhmen, e jo për të kaluarën. Gjithashtu duhet të rritet bashkëpunimi në fushën e **kulturës** me, dhe brenda rajonit.

Politika e BE-së për zgjerim duhet të vazhdojë të eksportojë stabilitet. Prandaj, BE-ja nuk mund dhe nuk do të importojë **mosmarrëveshje bilaterale**. Ato duhet të zgjidhen si çështje urgjente nga palët përgjegjëse. Arritja e këtij qëllimi do të lehtësohet nga një atmosferë e marrëdhënieve të mira fqinjësore, por do të jetë gjithashtu një test letre lakmushi se sa të shëndosha janë këto marrëdhënie. Kur mosmarrëveshjet rreth kufirit nuk zgjidhen në mënyrë bilaterale, palët duhet t'i paraqesin ato pa kushte për **arbitrazh përfundimtar ndërkombëtar, ligjërisht detyrues**, vendimet e të cilit duhet të zbatohen dhe respektohen plotësisht nga të dyja palët përpara aderimit, dhe duhet të merren parasysh në përgatitjen e Traktateve të Aderimit. Komisioni do t'i kushtojë vëmendje të veçantë procesit të zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve dhe do të sigurojë mbështetje sipas nevojës. Të gjitha vendet duhet të ndalojnë së keqpërdoruri çështjet e pazgjidhura në procesin e aderimit në BE. Si çështje



parimi, vendet që kryesojnë sa i përket rrugës së tyre në BE kanë interes strategjik në të qenët avokat, e jo përçarës, për aspiratat e fqinjëve të tyre. Vendet e rajonit janë të ndërvarura dhe do të përparojnë më shpejt nëse ndihmojnë njëra-tjetrën përgjatë rrugës së tyre.

Pa **normalizim** efektiv dhe gjithëpërfshirës të **marrëdhënieve Beograd-Prishtinë** përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja nuk mund të ketë stabilitet të qëndrueshëm në rajon. Një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërishit detyruese për normalizimin është urgjente dhe vendimtare në mënyrë që Serbia dhe Kosova të përparojnë në rrugët e tyre përkatëse evropiane.

## **5. Hapat e ardhshëm në rrugët përkatëse evropiane të Ballkanit Perëndimor**

Në vitet e ardhshme, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të kenë mundësinë të ecin përpara në rrugët e tyre përkatëse evropiane, në bazë të meritave të tyre dhe në shpejtësinë në të cilën i arrijnë ato merita. Mali i Zi dhe Serbia janë momentalisht vendet që kryesojnë sa i përket këtij procesi, dhe nën-seksioni i mëposhtëm ilustron piketat e mbetura në rrugët e tyre përkatëse. Shqipëria dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë po arrijnë përparim të konsiderueshëm në rrugën e tyre evropiane, dhe Komisioni është i gatshëm të përgatisë rekomandime për t'i hapur negociatat e aderimit, në bazë të kushteve të përmbushura. Komisioni do të fillojë përgatitjen e një opinioni në lidhje me aplikimin e Bosnje dhe Hercegovinës për anëtarësim pas pranimit të përgjigjeve gjithëpërfshirëse dhe të plota në pyetësorin e saj. Me përpjekje dhe angazhim të pandërprerë, Bosnja dhe Hercegovina mund të bëhet vend kandidat për aderim. Kosova e ka mundësinë që të arrijë progres të qëndrueshëm përmes zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe që të avancojë në rrugën e saj evropiane sapo të lejojnë rrethanat objektive. Kosova gjithashtu do të përfitojë në mënyrë të konsiderueshme nga një marrëveshje përfundimtare e normalizimit me Serbinë.

### **5.1 Ilustrim indikativ i hapave që kërkohet të ndërmerren nga Mali i Zi dhe Serbia për të përfunduar procesin e aderimit deri në vitin 2025**

Ky seksion përcakton hapat dhe kushtet kryesore në negociatat e aderimit të kërkuara në funksion të një perspektive të mundshme deri në vitin 2025. Ky ilustrim është thjesht indikativ dhe i bazuar në skenarin e rastit më të mirë. Nuk nënkupton automatizëm; procesi është dhe do të mbetet objektiv dhe i bazuar në meritë. Shërben për të ilustruar se sa shpejt do duhej të miratoheshin dhe zbatoheshin reformat transformuese të përcaktuara më sipër në mënyrë që të realizohet ky skenar. Çdo vend do të vlerësohet në mënyrë të pavarur sipas meritës së tij, në përputhje me progresin e arritur në përmbushjen e kushteve të vendosura.

#### **➤ Kompletimi i standardeve të përkohshme:**

Një fokus edhe më i madh në përmbushjen e **standardeve të përkohshme në fushën e sundimit të ligjit** është jetik. Këto kërkesa dhe kushte tashmë janë theksuar qartazi nga Komisioni në raportimin e tij të rregullt. Udhëheqësit e vendeve tani duhet t'i trajtojnë fuqishëm dhe me angazhim më të qartë sfidat ekzistuese. Në rastin e Serbisë duhet të përmbushen standardet e ndërmjetme (benchmark) në lidhje me normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën (kapitulli 35) si dhe duhet të arrihet urgjentisht një marrëveshje për normalizim e cila është gjithëpërfshirëse dhe ligjërishit detyruese.

#### **➤ Përcaktimi i qëndrimeve të përbashkëta të BE-së në fushat kryesore të politikave:**

Komisioni do të përgatisë një komunikatë me **vlerësimet e efektit të aderimit të ardhshëm** në fushat kryesore të politikave, siç është bujqësia, politika e kohezionit dhe buxheti. Kjo do t'ua mundësojë shteteve anëtare t'i përcaktojnë qëndrimet e përbashkëta të BE-së për

negociatat në kapitujt përkatës, me një të kuptuar të plotë të ndikimit të mundshëm, si dhe për të përcaktuar çdo masë kalimtare. Zbatimi i parimit të lëvizjes së lirë të punëtorëve në shtetet e reja anëtare është çështje shqetësuese për qytetarët e BE-së e gjithashtu edhe për ata të Ballkanit Perëndimor. Natyra e masave kalimtare në këtë fushë do të duhet të trajtohet në negociata. Në rastin e Serbisë, zbatimi i marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe ligjërishit detyruese për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën do të duhet të avancojë ndjeshëm.

➤ **Mbyllja e negociatave:**

Sapo të përmbusheshin të gjitha standardet e mbylljes për të gjithë kapitujt, duke përfshirë një arritje të besueshme dhe të qëndrueshme të zbatimit të reformave, veçanërisht në sundimin e ligjit, shtetet anëtare do të ishin në gjendje të bien dakord për **mbylljen e negociatave të përgjithshme** në një konferencë ndërqeveritare. Kjo do të kërkonte përparim të vazhdueshëm dhe të pakthyesëm sa i përket agjendës së reformave. Në rastin e Serbisë duhet të arrihet zbatimi i pakthyesëm i marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe ligjërishit detyruese me Kosovën, marrëveshje e cila reflekton konsolidimin e normalizimit të plotë të marrëdhënieve.

➤ **Nënshkrimi i Traktatit të Aderimit:**

Sapo vendi apo vendet të përfundojnë negociatat, **Traktati i Aderimit** mund të nënshkruhet pas opinionit të Komisionit, pëlqimit të Parlamentit Evropian dhe vendimit të Këshillit për pranimin e shteteve të reja anëtare.

➤ **Aderimi:**

**Aderimi mund të ndodhë vetëm** pasi të përfundojë ratifikimi i Traktatit të Aderimit në të gjitha shtetet anëtare të BE-së dhe në vendin ose vendet e pranuar, duke marrë parasysh kërkesat kushtetuese kombëtare përkatëse.

## **I. NJË PERSPEKTIVË E BESUESHME E ZGJERIMIT - KËRKON MBËSHTETJE NGA BASHKIMI EVROPIAN**

Perspektiva e zgjerimit e Ballkanit Perëndimor është para së gjithash në duart e vetë këtyre vendeve. Nga ana e saj, BE-ja duhet të mbetet e besueshme, e vendosur dhe e drejtë, duke përmirësuar politikat e saj për të mbështetur më mirë procesin e transformimit në rajon. Gjithashtu, duhet t'i përmbushë zotimet e saj ashtu sikur Ballkani Perëndimor që duhet t'i përmbushë zotimet e veta - në interesin e vet strategjik të Evropës.

Seksioni më poshtë, së bashku me Planin e Veprimit në shtojcë, paraqet një sërë iniciativash kryesore që shfaqin një përmirësim të konsiderueshëm të angazhimit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, në interes të përbashkët. Këto iniciativa do të kërkojnë mbështetje konkrete nga institucionet evropiane si dhe nga shtetet anëtare të BE-së.

Politika e BE-së për zgjerimin dhe procesin e stabilizimit dhe asociimit si dhe mjetet dhe instrumentet që sigurojnë këto mbeten shtylla e mbështetjes së saj për Ballkanin Perëndimor. Komisioni do të përpiqet të sigurojë koordinim më të madh të të gjitha aktiviteteve relevante, gjithashtu edhe me akterët tjerë, duke përfshirë institucionet ndërkombëtare financiare, dhe të promovojë më tej pronësinë rajonale e cila është vendimtare për të çuar rajonin përpara.

BE-ja duhet të rrisë angazhimin e saj sa i përket politikave me Ballkanin Perëndimor, duke u fokusuar në fusha me interes të përbashkët, siç janë drejtësia dhe punët e brendshme, duke përfshirë sigurinë dhe luftën kundër krimit të organizuar, ekonominë dhe tregun e vetëm, energjinë, transportin dhe politikat digjitale, politikat sociale, arsimin, hulumtimin dhe inovacionin, si dhe në punët e jashtme dhe në mbrojtje.

Bashkëpunimi në këto fusha do të mbështetë nga pjesëmarrja më e madhe e Ballkanit Perëndimor në **Këshillat joformalë** si dhe nga **kontaktet e rregullta të nivelit ministror**. Nga ana e tij, Komisioni do të përfshijë, sipas nevojës, Ballkanin Perëndimor në **komitetet teknike dhe grupet punuese të Komisionit**. Pas samitit të Ballkanit Perëndimor në Sofje që do të mbahet në maj të vitit 2018, udhëheqësit e BE-së duhet të vazhdojnë të angazhohen me homologët e tyre në Ballkanin Perëndimor, madje edhe në nivel të samitit.

Politikat e brendshme relevante të BE-së dhe programet e financimit duhet të zgjerohen më tej në Ballkanin Perëndimor dhe në mbështetjen e ofruar në mënyrë që vendet e Ballkanit Perëndimor ta shfrytëzojnë më mirë pjesëmarrjen ekzistuese në këto programe dhe rrjete të BE-së.

Komisioni do të rrisë ndihmën e tij teknike për Ballkanin Perëndimor për ta ndihmuar që të përfaqësohet me legjislacionin e BE-së dhe për të siguruar zbatimin e saj efektiv në praktikë. Shkëmbimet me **administratat** në rajon gjithashtu do të rriten dhe **formatet njerëzit-për-njerëzit** do të lehtësohen më tej, siç janë partneritetet lokale në mes të komunave në të gjithë rajonin me ato të vendeve të BE-së.

Për të ndjekur interesin tonë të përbashkët në fuqizimin e sigurisë sonë, dialogjet e strukturuar për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë/Politikën e Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje duhet gjithashtu të zgjerohen dhe thellohen me kontributet e mëdha në misionet dhe operacionet e BE-së në mbarë botën, me partnerët individual siç është e përshtatshme, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të pjesëmarrjes në veprimet në lidhje me kërcënimet hibride, inteligjencën, çështjet e hapësirës dhe reformën në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë. Në këtë kontekst, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet gjithashtu të shpejtojnë përafrimin e tyre me të gjitha qëndrimet e politikës së jashtme të BE-së, duke përfshirë masat kufizuese. Anëtarësimi në BE është një zgjedhje, dhe atë një zgjedhje cila kërkon ndarjen e parimeve, vlerave dhe qëllimeve të cilat Unioni përpiqet t'i promovojë në fqinjësinë e vet dhe më gjërë, duke përfshirë harmonizimin e plotë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë.

## 1. Mbështetje e forcuar për sundimin e ligjit

Duhet të intensifikohen Përpjekjet për të udhëzuar reformat e ndërlidhura me sundimin e ligjit në rajon, për të mbështetur hapat ambiciozë që duhet të ndërmerren nga vetë vendet. Mjetet e zhvilluara gjatë negociatave me Malin e Zi dhe Serbinë nën kapitujt e sundimit të ligjit duhet gjithashtu të përdoren në vendet tjera të Ballkanit Perëndimor si stimulim për miratimin e hershëm të reformave kyçe. Kjo do të përfshijë analizën e legjislacionit dhe praktikës në këtë fushë, duke qar në **krijimin e planeve të detajuara të veprimit** që prioritetizojnë çështjet kyçe dhe mbyllin monitorimin e zbatimit dhe ofrimin e rezultateve konkrete.

Ka përfitim të madh nga rritja e kontributeve të shteteve anëtare dhe ekspertëve për mbështetjen dhe ushtrimin e presionit për zbatimin e reformave. Duhet të ndërmerren vlerësime më të detajuara të sundimit të ligjit dhe **misionet këshilluese duhet të zgjerohen në tërë Ballkanin Perëndimor**, duke u bazuar në përvojën e misioneve të mëhershme këshilluese. Monitorimi i implementimit dhe zbatimi duhet të përmirësohen përmes shqyrtimeve kolegjiale më sistematike të bazuara në raste, të organizuara nga Komisioni me pjesëmarrjen e ekspertëve të shteteve anëtare. Duhet të prezantohet monitorimi i gjykimeve në fushën e rasteve të rënda të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Duhet të ndërmerren tregues për zhvillimin e punës për zbatimin e reformës. Progresi në reformën juridike duhet të matet me efikasitetin e drejtësisë që sistemi është në gjendje ta ofrojë tek qytetarët dhe bizneset e saj.

**Kornizat negociuese** për Malin e Zi dhe Serbinë theksojnë në veçanti nevojën për reforma në sundimin e ligjit që duhet të trajtohen në fillim të negociatave. Komisioni **rekomandon që të shfrytëzohet më shumë ndikimi i ofruar në kornizat negociuese**. Prandaj, duhet të kërkohet një përmirësim i konsiderueshëm në sundimin e ligjit dhe në veçanti rezultate konkrete në reformën juridike dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar para mbylljes së përkohshme të bisedimeve teknike mbi kapitujt tjerë të negociatave për aderim.

- Komisioni do t'i bëjë bashkë këto veprime në një iniciativë kryesore për **forcimin e sundimit të ligjit** në Ballkanin Perëndimor.

## 2. Përforcimi i angazhimit në siguri dhe migracion

**Bashkëpunimi strategjik dhe operacional** i përmirësuar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor për sigurinë, duke përfshirë përmes **agjencive relevante**, është shumë i rëndësishëm për adresimin në mënyrë efikase dhe efektive të kërcënimeve ekzistuese ndaj sigurisë dhe terrorizmit që ndikojnë në Union dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu duhet të përmirësohet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve për zbatimin e ligjit në nivel kombëtar dhe rajonal tek partnerët e Ballkanit Perëndimor.

Tashmë është duke u bërë shumë punë në nivel të BE-së për të ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve në Ballkanin Perëndimor dhe lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar policor dhe juridik për luftimin e kërcënimeve që kanë origjinën nga krimi i organizuar dhe terrorizmi, duke përfshirë radikalizimin që qon në ekstremizëm të dhunshëm, sifda e luftëtarëve të huaj terrorist dhe trafikimi i armëve të zjarrit dhe eksplozivëve. Ky angazhim duhet të fuqizohet mëtej, në bazë të iniciativave të suksesshme në fushën e sigurisë dhe kundër terrorizmit dhe të mbështeten me dialogun e vazhdueshëm të politikave të sigurisë ndërmjet Unionit dhe Ballkanit Perëndimor. Partnerët e Ballkanit Perëndimor duhet të ndërlihen më afër – në baza ad hoc – me diskutimet përkatëse të politikave të sigurisë që zhvillohen në BE.

**Agjencitë e BE-së**<sup>4</sup>, të mbështetura nga Interpoli, do të thirren për të luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e bashkëpunimit strategjik, operacional, policor dhe juridik, duke përfshirë dërgimin e zyrtarëve ndërlidhës të Europolit në rajon dhe promovimin e mëtejshëm të Ekipeve të Përbashkëta Hetimore. Marrëveshjet për bashkëpunim me Eurojust duhet të finalizohen sa më parë që të zhvillohen standardet e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave.

Angazhimi i rifuqizuar **kundër terrorizmit dhe radikalizimit** duhet të përfshijë fuqizimin e kapaciteteve strategjike, legjislative dhe institucionale në vendet partnere, duke u bazuar në dialogjet dhe planet e përbashkëta të veprimit të dedikuara kundër terrorizmit, dhe duke vazhduar vendosjen e ekspertizës kundër terrorizmit në Ballkanin Perëndimor. Bashkëpunimi duhet të përmirësohet së bashku me lidhjen e brendshme-të jashtme për sigurinë me ndihmën e agjencive të BE-së dhe Interpolit, duke përfshirë shkëmbimin e informacioneve në lidhje me luftëtarët e huaj terrorist dhe zgjerimin e mbështetjes së Rrjetit për Vetëdijësim mbi Radikalizimin në Ballkanin Perëndimor. Koherenca dhe sinergjitë e veprimeve duhet të sigurohen nëpërmjet Iniciativës së Ballkanit Perëndimor kundër Terrorizmit.

---

<sup>4</sup>Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (Europol), Agjencia Evropiane e Rojave Kufitare dhe Bregdetare (EBCGA), Njësia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim Gjyqësor (Eurojust), Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnime dhe Zbatim të Ligjit (Cepol)

Bashkëpunimi operativ për luftimin e llojeve të ndryshme të **krimit të organizuar** në kontekst të ciklit të politikave duhet të zgjerohet gjithnjë e më shumë për të përfshirë Ballkanin Perëndimor. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ofrimit të mbështetjes së rritur për ngritjen e kapaciteteve në fushën e **sigurisë kibernetike dhe luftës kundër krimeve kibernetike**. Do të rritet bashkëpunimi me agjencitë relevante të BE-së, si Europol dhe Rrjeti Evropian dhe Agjencinë për Sigurinë e Informacionit.

Në të njëjtën kohë, është thelbësore që të rritet më tej bashkëpunimi strategjik dhe operacional me Ballkanin Perëndimor në lidhje me **migrimin dhe menaxhimin e kufirit**. Kjo përfshinë sigurimin e qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare, shkëmbimin e informacioneve relevante (si analizat e rrezikut), përmirësimin e kontrollit kufitar, sigurimin e zbatimit efikas të politikave të ripranimit dhe kthimit dhe luftës kundër migrimit të parregullt dhe trafikimit të migrantëve. Gjithashtu është i nevojshëm fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal (përfshirë me agjencitë e BE-së<sup>5</sup> dhe zyrtarët përkatës të ndërlidhjes në rajon), dhe konsolidimi i mëtejshëm i kapaciteteve për menaxhimin e kufirit dhe migracionit.

Prandaj, Komisioni propozon vazhdimin e procesit të arritjes së marrëveshjeve për statusin e Rojave Kufitare dhe Bregdetare Evropiane me partnerët e Ballkanit Perëndimor, duke paraparë një kornizë të qartë ligjore dhe masa mbrojtëse për bashkëpunim më të afërt operativ. Kjo duhet të përfshijë mundësinë e vendosjes dhe zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta operacionale të autoriteteve kompetente kombëtare të shteteve anëtare të BE-së dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor, së bashku me Agjencinë Evropiane për Rojet Kufitare dhe Bregdetare. Do të jetë i rëndësishëm edhe thellimi i bashkëpunimit rajonal dhe përmirësimi i shkëmbimit të informacioneve ndërmjet Unionit dhe Ballkanit Perëndimor në këtë fushë.

Për të përcjellur veprime të ndryshme që duhet të merren nga agjencitë e BE-së në lidhje me Ballkanin Perëndimor, Komisioni ka për qëllim të krijojë dhe koordinojë një **Task Forcë ndër-agjenci të BE-së**, në linjë me mandatet e tyre përkatëse.

- Komisioni do të bashkojë këto veprime në një iniciativë kryesore për **fuqizimin e angazhimit për siguri dhe migrim** në Ballkanin Perëndimor.

### **3. Mbështetja e zhvillimit socio-ekonomik**

Investimi në Ballkanin Perëndimor është investim në Evropë. Investimet do të rriten vetëm nëse fuqizohet qeverisja ekonomike dhe ndiqen reformat strukturore për rritjen e konkurrueshmërisë. Masat e mëposhtme shërbejnë për mbështetjen e këtij qëllimi dhe përmirësimin e rritjes dhe krijimit të vendeve të punës në veçanti për të rinjtë e këtij rajoni. **Korniza Investive e Ballkanit Perëndimor** e financuar nëpërmjet Instrumentit për Asistencë Para-Anëtarësimi do të jetë gjithnjë e më shumë në qendër të nxitjes së investimeve në rajon. Për këtë qëllim, do të zgjerohet më tej për tërheqjen dhe koordinimin e investimeve bilaterale të donatorëve dhe Institucioneve Financiare Ndërkombëtare. Parashihet rritja e fondeve në fushat e transportit, energjisë, sektorit social, mjedisit dhe zhvillimit të sektorit privat, duke përfshirë ekonominë digjitale. Për lidhjen e zhvillimit socio-ekonomik në rajon me prioritetet investuese të Unionit, Komisioni ka për qëllim që të **shtytë në mënyrë të konsiderueshme garancitë nën Kornizën Investive të Ballkanit Perëndimor** për të grumbulluar investimet

---

<sup>5</sup> Puna e agjencive të mësipërme është e rëndësishme sikurse edhe ajo e Zyrës Evropiane për Mbështetjen e Azilit.

private në rajon, plotësisht në përputhje me iniciativat ekzistuese. Në funksion të Kornizës së ardhshme financiare shumë-vjeçare, Ballkani Perëndimor duhet gjithashtu të mbulohet në marrëveshjet e ardhshme të mundshme për kreditim.

**Zona Ekonomike Rajonale** është një hap thelbësor për të qar përpara integrimin ekonomik ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe shtytjen e atraktivitetit të tregut rajonal. Komisioni do të vazhdojë mbështetjen e zhvillimit të integritit ekonomik ndër-rajonal, duke përfshirë përmes mobilizimit të ekspertizës së vet për të ndihmuar në zbatimin e planit të veprimt të Zonës Ekonomike Evropiane, në veçanti zonat e mbuluara me *acquis* të BE-së.

Përderisa tregtia ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor ishte mbi 43 miliardë Euro në vitin 2016, ekziston një potencial i konsiderueshëm për rritje të mëtejshme. Për të realizuar këtë potencial, Komisioni do të **lehtësojë më tej tregtinë ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor**. Kjo do të përfshijë zhvillimin e programeve për njohje të ndërsjellë në bazë të Zonës Qendrore Evropiane për Tregti të Lirë dhe Zonës Ekonomike Rajonale (p.sh. Operatorët e Autorizuar Ekonomik). Anëtarësimi në **Organizatën Botërore të Tregtisë** është parakusht për aderim në BE dhe mund të stimulojë rritjen ekonomike dhe të nxisë investime të konsiderueshme për rajonin. Komisioni do të vazhdojë ndihmën për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Serbinë në procesin e aderimit të tyre në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Zhvillimi i një **sektori të fuqishëm privat të udhëhequr nga ndërmarrësit nga rajoni dhe nga BE-ja** do të shfrytëzojë më mirë dinamizmin e të rinjëve të rajonit dhe të nxisë integrimin ekonomik me përfitim të ndërsjellë. Do të vazhdojë inkurajimi i lidhjeve ndërmjet komunitetit biznesor të diasporës në BE dhe ndërmarrësve në BE dhe Ballkan Perëndimor, duke përfshirë nëpërmjet Programit të BE-së për Konkurrueshmërinë e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme. Nevojiten masa për rritjen e qasjes në financa dhe shfrytëzimin e potencialit për rritje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Për të shtytur ndërmarrësinë dhe inovacionin, Komisioni do të lansojë një skemë për mbështetjen e transferimit të teknologjisë dhe biyneseve fillestare (**start-ups**) në tërë rajonin dhe mbështetjen e përpjekjeve që kanë për qëllim specializimin e mençur, si dhe ekonominë qarkulluese. Programet Kornizë të BE-së tashmë janë të hapura për Ballkanin Perëndimor. Për të siguruar pjesëmarrjen e tyre më efikase, duhet të parashihet integrimi i mëtejshëm në rrjetet ekzistuese të njohurisë në BE, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve për hulumtim dhe inovacion. Bashkëpunimi mund të zhvillohet më tej nën iniciativa tjera, duke përfshirë strategjitë makro-rajonale të BE-së.

Komisioni do të punojë në përkrahjen e profesionalizmit dhe pavarësisë së zyrtarëve të **prokurimit publik** dhe në forcimin e mekanizmave mbikëqyrës, për të mundësuar monitorimin e ciklit të plotë të tenderit. Në mënyrë që këto përpjekje të jenë efikase nevojitet një angazhim i qëndrueshëm politik, për të adresuar korrupsionin.

Ushtrimi vjetor i **programit të reformës ekonomike**, i udhëhequr nga Komisioni me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, është një mjet vendimtar për të mbështetur modernizimin e ekonomive të tyre dhe për të arritur një koordinim më të ngushtë ekonomik me BE-në. Komisioni do ta forcojë këtë ushtrim, ta sjellë atë edhe më afër, në përputhje me semestrin ekzistues evropian për shtetet anëtare të BE-së dhe të ofrojë asistencë teknike më të avancuar.

Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale reflekton parimet dhe të drejtat që janë thelbësore për tregjet e punës dhe sistemet e mirëqenies, të drejtë dhe të mirëfunksionuar. Përmes një **dimensioni të ri, të përforcuar social** për Ballkanin Perëndimor, Komisioni do të punojë për të mbështetur punësimin dhe politikën sociale në rajon, duke inkurajuar angazhimin e duhur prej të gjitha niveleve të qeverisë, partnerëve socialë dhe shoqërisë civile. Kjo do të përfshijë një fokus të rritur, në **punësim dhe reforma sociale** nëpërmjet monitorimit më të madh të

politikave përkatëse, përfshirë edhe në kontekstin e programeve të reformave ekonomike. Komisioni propozon një takim vjetor ministror, BE - Ballkani Perëndimor, për çështjet sociale dhe të punësimit, për të shkëmbyer pikëpamjet. Më shumë asistencë financiare duhet të parashihet në sektorin social, posaçërisht investim në arsim dhe shëndetësi, për të përkrahur përfshirjen sociale.

Përkrahje e shtuar duhet t'i ofrohet arsimimit, në veçanti **arsimit dhe aftësimin profesional dhe shkathtësive**, si dhe trajnimit të mësuesve dhe arsimimit parashkollor. **Financimi në kuadrin e programit Erasmus+ do të dyfishohet**, për të ndihmuar edhe më shumë të rinjtë të Ballkanit Perëndimor, që të studiojnë dhe përfitojnë përvojë në BE, duke e çuar më tej zhvillimin ekonomik dhe promovimin e vlerave të përbashkëta. Do të themelohet një skemë pilot e mobilitetit, për **nxënësit dhe trajnerët në arsimin dhe aftësimin profesional**, në bashkëpunim të ngushtë me akterët, duke përfshirë Fondacionin Evropian të Trajnimit.

- Komisioni do t'i bashkojë këto veprime në një iniciativë kryesore, për të **mbështetur zhvillimin socio-ekonomik** në Ballkanin Perëndimor.

#### 4. Rritja e lidhshmërisë

Përmirësimi i lidhshmërisë brenda Ballkanit Perëndimor paraqet një interes strategjik për të dyja palët. Rritja e lidhjeve të transportit dhe energjisë do të mundësojë rritjen e konkurrencës, rritjen ekonomike dhe sigurinë e furnizimit, dhe njëkohësisht është një parakusht i rëndësishëm për integrimin ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor. Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe Traktati i Komunitetit të Transportit, si dhe Zona e Përbashkët Evropiane e Aviacionit ofrojnë korniza rregulluese të avancuara të cilat - të kombinuara me bashkëpunim të fortë politik në rajon – në masë të madhe lehtësojnë lidhshmërinë ndër-rajonale.

Ballkani Perëndimor është i rrethuar gjeografikisht nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe, gjithashtu, është një prioritet politik për të **lidhur infrastrukturën midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor** dhe për të përshpejtuar zhvillimin e rrjeteve të ndërlidhura trans-Evropiane, në fushën e transportit, energjisë dhe shërbimeve digjitale. Investimi në rrjetet infrastrukturore sjell përfitime të prekshme, të njohura qartë nga qytetarët dhe biznesi në BE dhe Ballkanin Perëndimor. Përveç rritjes së financimit të këtyre rrjeteve dhe krijimit të një skeme të re të garancisë për investimet private, Komisioni do të punojë, për të siguruar përdorimin më efektiv të dispozitave ekzistuese të **Instrumentit të Lidhjes Evropiane** për vendet e Ballkanit Perëndimor. Komisioni do të shqyrtojë mundësitë për të thjeshtëzuar pjesëmarrjen e tyre në Kornizën e ardhshme Financiare Shumëvjeçare.

*Një union energjetik me Ballkanin Perëndimor:* Për të forcuar **Unionin Energjetik të BE-së, të gjitha dimensionet** e saj duhet të zgjerohen në Ballkanin Perëndimor: duke mbështetur sigurinë e energjisë, integrimin e tregut dhe tranzicionin e energjisë, duke përfshirë eficiencën energjetike dhe energjitë e rinovueshme. Në këtë kontekst, secili vend duhet të plotësojë të gjitha reformat e nevojshme dhe t'i orientojë plotësisht politikatat e tyre, në përputhje me pesë shtyllat e Unionit të Energjisë. Duhet të mbështetet ngritja e kapaciteteve të **rregullatorëve të energjisë dhe operatorëve të sistemit të transmisionit**, në Ballkanin Perëndimor, ashtu që ata të mund të marrin pjesë plotësisht në rrjetet në nivel të BE-së. Duhet të vazhdohet puna për të përfunduar **Tregun Rajonal të Energjisë Elektrike** në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurohet integrimi i saj në Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike të BE-së.

*Drejt një unioni të vërtetë të transportit me Ballkanin Perëndimor:* Zbatimi i Traktatit të

Komitetit të Transportit, i cili hyri në fuqi në vitin 2017, do të jetë hapi kryesor që do të çonte në integrimin progresiv të rajonit në tregun e transportit të BE-së. Marrëveshjet mbi korridoret prioritare të transportit ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor si pjesë e rrjetit trans-evropian të transportit tashmë janë në fuqi. Tani, këto duhet të bëhen realitet, për të siguruar kontributin e tyre në rritjen e konkurrenshërisë së kontinentit si tërësi. Përveç investimeve, prioritet është të bëhet harmonizimi me standardet operacionale të BE-së. Kjo do të kërkojë - ndër reformat e tjera kyçe - masa të zgjeruara për të **hequr pengesat administrative dhe barrierat në kufij**, me qëllim të promovimit të operacioneve të integruara rrugore dhe hekurudhore. Nevojitet **një strategji e re hekurudhore**, për të sjellë Ballkanin Perëndimor në rrjetin dhe tregun kryesor të BE-së dhe për të promovuar hapjen e tregut hekurudhor rajonal. Për më tepër, do të nevojiten përpjekje të synuara, për të zvogëluar numrin joproporcionalisht të lartë të fatkeqsive rrugore përmes një **strategjie të re të sigurisë rrugore**.

- Komisioni do t'i bashkojë këto veprime në një iniciativë kryesore për të **mbështetur lidhshmërinë** në Ballkanin Perëndimor.

## 5. Lansimi i një Agjende digjitale për Ballkanin Perëndimor

Zhvillimi i **Tregut të Vetëm të Brendshëm Digjital të BE-së** i kontribuon zhvillimit të bizneseve, krijimit të rritjes, rritjes së produktivitetit, promovimit të inovacionit, transformimit të shërbimeve publike dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve. Është thelbësore që Ballkani Perëndimor të përfshihet në përpjekjet e BE-së, për të përqafuar ndryshimet teknologjike, që ata të jenë në gjendje të përfitojnë nga mjetet digjitale, duke siguruar një të ardhme të begatë dhe të qëndrueshme për qytetarët e tyre.

Së bashku me partnerët në Ballkanin Perëndimor, Komisioni do të lansojë një **Agjendë Digjitale për Ballkanin Perëndimor**, duke përfshirë një udhërrëfyes për të lehtësuar uljen e kostos së **roamingut**. Do të ofrohet mbështetje për **vendosjen e brezit të gjërë** brenda Ballkanit Perëndimor. **Shoqëria digjitale** duhet të zhvillohet dhe kështu, do të ofrohet përkrahje, në veçanti, për shërbimet e eQeveria, eProkurimi dhe eShërbimet Shëndetësore, si dhe për zhvillimin e **shkathtësive digjitale**. Komisioni do të mbështesë ndërtimin e kapaciteteve në **besimin dhe sigurinë** dhe **digjitalizimin e industrisë**, në Ballkanin Perëndimor, për të siguruar që të gjithë sektorët të përfitojnë nga risitë digjitale. Këto përpjekje do të plotësohen nga mbështetja të zgjeruar për miratimin, implementimin dhe zbatimin të **acquis-it**, në fushën e tregut të vetëm digjital.

- Komisioni do t'i bashkojë këto veprime në një iniciativë kryesore për **një Agjendë Digjitale** për Ballkanin Perëndimor.

## 6. Mbështetja e pajtimit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore

Nxitja e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe pajtimi ka nevojë për pronësi të fortë në Ballkanin Perëndimor dhe duhet të drejtohet në radhë të parë nga vendet e rajonit. Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë duhet të vazhdojnë të përforcohen përmes nismave të bashkëpunimit rajonal. Komisioni është i gatshëm të vazhdojë të mbështesë këtë bashkëpunim, qoftë në agjendën e lidhshmërisë, përmes formatit të WB6 dhe iniciativave, që bashkojnë krerët e shteteve dhe qeverive nga rajoni, ose iniciativave të tjera që forcojnë pronësinë e tyre në bashkëpunimin rajonal.



Komisioni do të zgjerojë më tej mbështetjen për iniciativat e pajtimit, duke përfshirë ato që adresojnë drejtësinë tranzicionale dhe kërkojnë të kapërcejnë trashëgiminë e konfliktit të kohëve të fundit. Do të ketë një vazhdimësi të mbështetjes për punën e Mekanizmit për Tribunalet Penale Ndërkombëtare dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës. Komisioni, gjithashtu, do të shqyrtojë se si më së miri, të vazhdojë punën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, duke nxitur bashkëpunimin rajonal, për të zgjidhur çështjen e personave të zhdukur dhe për të shqyrtuar se çfarë mund të bëhet më tepër, për të zvogëluar fatkeqësinë nga minat tokësore.

Mbështetja e arsimimit dhe potencialit të të rinjve në Ballkan është thelbësore për zhvillimin e mëtejshëm të rajonit dhe një parakusht për bashkëjetesë paqësore dhe pajtim. Përveç arsimimit, bashkëpunimi do të rritet në fushën e **kulturës, rinisë dhe sportit**. Fushëveprimi dhe shtrirja e **Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor** do të zgjerohet. Përveç rritjes së fondeve sipas programit Erasmus +, Komisioni do të vazhdojë të nxisë lidhjet kulturore me rajonin. Kjo do të përfshijë punën për të mbrojtur trashëgiminë kulturore të Ballkanit Perëndimor dhe promovimin e industrive të saj kulturore dhe krijuese.

- Komisioni do t'i bashkojë këto veprime në një iniciativë kryesore për të **mbështetur pajtimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë** në Ballkanin Perëndimor.

## **II. PËRGATITJA E BE-së PËR TË MIRËPRITUR ANËTARËT E RINJ**

### **1. Çështjet institucionale**

Vetë BE-ja duhet të sigurohet se është e gatshme institucionalisht për të mirëpritur shtetet e reja anëtare pasi ato t'i kenë përmbushur kushtet e caktuara. **BE-ja duhet të jetë më e fuqishme dhe më solide, para se të zgjerohet.**

Përdorimi i votimit të shumicës së kualifikuar në Këshill është një mjet kyç, që mundëson marrjen e vendimeve të nevojshme në një Bashkim Evropian prej 27 shteteve. Për të siguruar vendim-marrje efektive, do të jetë e nevojshme që të paktën fushat e politikave të kenë shumicën e votave të kualifikuar në Këshill. Komisioni do t'i miratojë Komunikatat mbi mundësinë e rritjes së mëtejshme të përdorimit të votimit me shumicë të kualifikuar në tremujorin e tretë të vitit 2018.

**Të jesh anëtar i Bashkimit Evropian do të thotë të pranosh dhe të promovosh vlerat e tij.** Kur merret parasysh e ardhmja e Bashkimit Evropian, duhet të krijohet një mekanizëm më efektiv për të siguruar se mund të ndërmerren masa efektive për të trajtuar një kërcënim sistematik ose një shkelje sistematike të këtyre vlerave nga çdo shtet anëtar i BE-së. Komisioni do të paraqesë një iniciativë për të forcuar zbatimin e sundimit të ligjit në Bashkimin Evropian në tetor të vitit 2018. Traktatet e pranimit mund të sigurojnë një bazë ligjore për krijimin e një mekanizmi të tillë brenda kornizës së Traktateve.

Aderimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor do të ketë një **ndikim në marrëveshjet ekzistuese institucionale në BE**. Propozimet për t'i adresuar këto çështje institucionale do të nevojiten para mbylljes së negociatave. Kur adresohen marrëveshjet institucionale për zgjerimin e ardhshëm, duhet të merret parasysh anëtarësimi i ardhshëm i vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Veçanërisht, përdorimi i votimit me shumicë të kualifikuar në Këshill është një mjet kyç që mundëson marrjen e vendimeve të nevojshme në një Bashkim Evropian prej 27 shteteve.

Marrëveshjet e veçanta dhe **zotimet e parevokueshme** gjithashtu duhet të vihen në vend për të siguruar që shtetet e reja anëtare nuk janë në gjendje të bllokojnë pranimin e kandidatëve të tjerë të Ballkanit Perëndimor. Marrëveshje e veçantë gjithashtu do të nevojitet në lidhje me gjuhët kombëtare të shteteve të ardhshme anëtare.

Shumë para se të mbyllet negociatat e përgjithshme të aderimit, Komisioni do të japë **vlerësime se si** fushat kyçe të politikës, siç është bujqësia, politika e kohezionit dhe buxheti do të ndikohen nga aderimi i një shteti të ri anëtar. Kjo do t'u mundësojë shteteve anëtare të përcaktojnë pozicionet e përbashkëta të BE-së për kapitujt përkatës me një të kuptuar të plotë të ndikimit të mundshëm si dhe marrjen e masave lehtësuese.

## 2. Sigurimi i mjeteve financiare për një aderim të suksesshëm

Instrumenti për Asistencë të Para-Anëtarësimit e mbështet Ballkanin Perëndimor në përgatitjen e tyre për pranim dhe lehtëson bashkëpunimin rajonal dhe ndërkufitar. Mes viteve 2007-2017, BE-ja ka investuar më shumë se 8.9 miliardë euro në rajon përmes Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit. Në vitin 2018, parashikohet të investohen 1,07 miliardë euro. Fondet e Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit do t'i përshtaten edhe më shumë nevojave të vendeve. Zbatimi i kësaj strategjie do të kërkojë rritje të fondeve. Prandaj, Komisioni parashih një **rritje graduale të mbështetjes së Instrumentit për asistencë të Para Anëtarësimit për Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2020** për aq sa lejojnë rialokimet e fondeve brenda **instrumentit ekzistues për asistencë të Para Anëtarësimit**.

Duke marrë parasysh mësimet e nxjerra nga zgjerimet e mëparshme, duhet të parashikohet një **tranzicion gradual dhe i pandërprerë** nga statusi i para anëtarësimit në atë të shtetit anëtar, për të lejuar **zhvillimin e nevojshëm të kapacitetit absorbues**. Kjo duhet të obligojë një rritje graduale në Kornizën e re Financiare shumëvjeçare të fondeve të Instrumentit për Asistencë të Para-Anëtarësimit para aderimit, shoqëruar me një shkallëzim të shpenzimeve pas aderimit. Kjo do të thotë në mënyrë efektive që përderisa një shtet i ri anëtar nuk mund të presë që të marrë alokimet e plota të shpenzimeve të BE-së menjëherë pas aderimit, qasja e tij në fondet e para-anëtarësimit do të rritet në mënyrë të konsiderueshme përpara se t'i bashkohet BE-së.

Kushtëzimi i lidhur me asistencën tonë dypalëshe do të forcohet. Rritja e fondeve në kuadrin financiar të tanishëm dhe të ardhshëm shumëvjeçar duhet të lidhet me përparimin në zbatimin e reformave themelore dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore.

Duke pasur parasysh nivelin relativisht të ulët të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) dhe nivelet e popullsisë, ndikimi i aderimit të Ballkanit Perëndimor në buxhetin e BE-së pritet të jetë shumë i kufizuar. Sidoqoftë, zgjerimi i Bashkimit Evropian ka një kosto dhe do të obligojë shpenzime të mëtejshme për të gjitha shtetet anëtare. Korniza financiare shumëvjeçare pasqyron prioritetet politike të BE-së. Nevojat për përgatitjet e aderimit do të duhet të merren parasysh në Kornizën e ardhshme financiare shumëvjeçare, ku do të përfshihen dispozita specifike për zgjerimin. Nëse disa kandidatë janë gati t'i bashkohen BE-së gjatë periudhës së ardhshme të **Kornizës Financiare shumëvjeçare**, do të duhej të bëhen **rregullime të nevojshme**.

## 3. Komunikimi

Për të qenë procesi i aderimit një sukses, **mundësitë dhe sfidat** e tij duhet të komunikohen më qartë, në rajon dhe në BE. Në Ballkanin Perëndimor, qeveritë janë kryesisht përgjegjëse për t'iu siguruar informata adekuate qytetarëve dhe biznesit, si dhe për të krijuar një konsensus kombëtar rreth qëllimit të tyre strategjik.

Nga ana e BE-së, është detyrë e Shteteve Anëtare që të informojnë qytetarët e tyre dhe t'u sigurojnë faktet rreth mundësive dhe sfidave të procesit. Komisioni do të mbështesë këto përpjekje duke rritur **komunikimin e vet strategjik** në vendet dhe në Bashkimin Evropian, si dhe të sigurojë dukshmërinë e politikës së zgjerimit.

### **III. PËRFUNDIME**

BE-ja ka kohë që ka mbështetur perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. E ardhmja e rajonit, si pjesë integrale e BE-së është në **interesin e vet politik, të sigurisë dhe atë ekonomik**. Politika e zgjerimit të BE-së është pjesë përbërëse e strategjisë më të madhe, për të forcuar Bashkimin Evropian deri në vitin 2025. Me vullnet të fortë politik, shpërndarja e reformave reale dhe të qëndrueshme dhe zgjidhjet përfundimtare për mosmarrëveshjet me fqinjët, Serbia dhe Mali i Zi **mund të jenë potencialisht gati për anëtarësim me këtë datë**. Aderimi është dhe do të **mbetet një proces i bazuar në merita**, i cili varet plotësisht nga progresi objektiv i arritur nga secili vend.

Për të **përbushur kriteret e mirë-vendosura të anëtarësimit** dhe në interesin e tyre, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të zbatojnë **reforma gjithëpërfshirëse** në fusha vendimtare. **Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe qeverisja** duhet të forcohen ndjeshëm. Reformat gjyqësore, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe reforma e administratës publike duhet të japin rezultate reale si dhe të rritet seriozisht funksionalizimi i institucioneve demokratike. Reformat ekonomike duhet të ndiqen me energji dhe të adresohen dobësitë strukturore, konkurrueshmëria e ulët dhe papunësia e lartë.

Të gjitha vendet duhet të zotohen në mënyrë të qartë, si në fjalë, ashtu dhe në vepra, të kapërcejnë trashëgiminë e së kaluarës, duke arritur pajtimin dhe zgjidhur çështjet e hapura përpara aderimit të tyre në BE, në veçanti mosmarrëveshjet e kufirit. Duhet të ekzistojë një **marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërish e detyrueshme për normalizim** midis Serbisë dhe Kosovës, në mënyrë që ato të përparojnë në rrugët e tyre përkatëse evropiane.

**BE-ja do të rrisë ndjeshëm mbështetjen e saj** ndaj procesit të transformimit në Ballkanin Perëndimor. Komisioni parasheh një **Plan Veprimi për Mbështetjen e Transformimit të Ballkanit Perëndimor**, i bashkangjitur kësaj Strategjie. Ai përfshin **gjashtë iniciativa kryesore**, që synojnë fusha specifike të interesit, si për BE-në ashtu edhe për vetë vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe një numër masash të reja në fushat me interes të fortë të përbashkët:

**Iniciativa për të forcuar sundimin e ligjit:** Mjetet ekzistuese të negocimit, siç janë **planet e detajuara të veprimit**, do të shpalosen për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Vlerësimi i zbatimit të reformave do të rritet, duke përfshirë **misionet e reja këshilluese në të gjitha vendet**. Do të bëhet përdorimi më i gjerë i **përparësive të parapara në kornizën negociuese** me Serbinë dhe Malin e Zi.

**Iniciativa për të përforcuar angazhimin në siguri dhe migracion:** Bashkëpunim i përforcuar për luftimin e krimin të organizuar, luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për sigurinë e kufijve dhe menaxhimin e migracionit. **Zyrtarët ndërlihdës të Europolit** do të sistemohen në rajon; **Ekipe të Përbashkëta Hetimore** të promovuara më tej dhe **marrëveshjet e lidhura të statusit me Agjencinë e Rojës Kufitare dhe Bregdetare**.

**Iniciativa për të rritur mbështetjen për zhvillimin socio-ekonomik:** do të përfshijë zgjerimin e **Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor, një shtytje e konsiderueshme në ofrimin e garancive për të shtuar investimet private,** mbështetje për startup-ët dhe NVM-të dhe lehtësim më i madh i tregtisë. Një **dimension i ri social i përforcuar** do të përqendrohet më shumë në punësim dhe politikat sociale, me rritjen e ndihmës financiare për të mbështetur sektorin social, në veçanti arsimin dhe shëndetin. Financimi nga **Erasmus + do të dyfishohet.**

**Iniciativa për të rritur lidhshmërinë e transportit dhe energjisë** në rajon dhe me BE-në, duke përfshirë **mbështetjen e investimeve të reja.** Do të bëhet përdorimi më efektiv i **Instrumentit të Lidhjes Evropiane** në vendet e Ballkanit Perëndimor. Për të forcuar **Unionin Energjetik të BE-së, të gjitha dimensionet e saj** duhet të zgjerohen në Ballkanin Perëndimor.

**Iniciativa për një Agjendë Digjitale për Ballkanin Perëndimor:** do të përfshijë një udhëzues për të lehtësuar **uljen e kostove të roamingut,** mbështetjen për **instalimin e teknologjisë brezgjërë (broadband)** në rajon dhe zhvillimin e platformave elektronike siç janë **e-Qeverisja, e-Prokurimi, e-Shëndetësia** dhe shkathtësitë digjitale.

**Iniciativa për të mbështetur pajtimin dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore:** do të përfshijë mbështetjen e drejtësisë tranzicionale, personave të zhdukur dhe rritjen e bashkëpunimit në arsim, kulturë, rini dhe sport dhe zgjerimin e fushëveprimit të Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor.

Në mars të vitit 2018, shërbimet e Komisionit do të thërrasin një takim fillestar koordinues me Shtetet Anëtare në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin e Veprimit të Jashtëm Evropian për të diskutuar Planin e Veprimit dhe mekanizmat për bashkëpunim operacional për zbatimin e tij.

**BE-ja duhet të jetë e përgatitur** për të mirëpritur anëtarët e rinj, përfshirë edhe nga këndvështrimi institucional dhe financiar, pasi të kenë plotësuar kushtet e nevojshme. Komisioni do të përgatisë vlerësimet e ndikimit në fushat kryesore të politikave shumë përpara aderimit. Për të siguruar **fonde adekuate për mbështetjen e kësaj strategjie** dhe një tranzicion të pandërprerë drejt anëtarësimit, Komisioni propozon që **gradualisht të rrisë fondet** në kuadër të **Instrumentit të Ndihmës së Para-Anëtarësimit** dhe të sigurohet që ofrohet ndihmë adekuate **në Kornizën e ardhshme Financiare shumëvjeçare** për t'u kujdesur për aderimet e mundshme. Për të siguruar vendim-marrje efektive, do të jetë e nevojshme që së paku të ruhet dhe të konsiderohet zgjerimi i fushave të politikave nën votim të shumicës së kualifikuar në Këshill. Duhet të vendoset një sistem më efektiv për të trajtuar kërcënimet sistematike ose shkeljet e sundimit të ligjit në çdo Shtet Anëtar të BE-së. Aktivitetet e komunikimit do të shtohen.

Perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor është e qartë dhe e padyshimtë dhe kushtet dhe kriteret për anëtarësim në BE janë të përcaktuara mirë. Nëpërmjet kësaj strategjie, BE-ja do të jetë në gjendje të ofrojë **mbështetje të pashembullt për këtë qëllim.** Ka ende shumë punë për t'u bërë për vendet në fjalë që të jenë në gjendje t'i përmbushin këto kriteret. Qeveritë duhet të sigurojnë procese më gjithëpërfshirëse të reformave që inkuadrojnë të gjithë akterët dhe shoqërinë në masë të gjerë. Më thelbësore, udhëheqësit në rajon nuk duhet të lënë asnjë dyshim në angazhimin dhe orientimin e tyre strategjik. Në fund të fundit, ata duhet të marrin përgjegjësinë për ta bërë këtë mundësi historike një realitet.



Strasbourg, 6.2.2018  
COM(2018) 65 final

SHTOJCË

**SHTOJCË**

*e*

**KOMUNIKATËS NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN,  
KËSHILLIN, KOMITETIN EKONOMIK DHE SOCIAL EVROPIAN DHE  
KOMITETIN E RAJONEVE**

**Perspektiva kredibile e zgjerimit dhe angazhimi i shtuar i BE-së me Ballkanin  
Perëndimor**

## SHTOJCË

<b>Plani i Veprimit për Mbështetjen e Transformimit të Ballkanit Perëndimor</b>	
<b>Veprimet kryesore</b>	<b>Koha</b>
<b>1. Forcimi i mbështetjes për sundimin e ligjit</b>	
1.1. Mbështetje për krijimin e <b>planeve të detajuara të veprimit</b> në Ballkanin Perëndimor për të trajtuar mangësitë dhe prioritizimin e çështjeve kryesore për përafrimin e legjislacionit dhe praktikës ekzistuese me standardet e BE-së.	2019-20
1.2. Zgjerimi i <b>misioneve këshilluese për sundimin e ligjit</b> në Ballkanin Perëndimor dhe nxitja e një mbështetjeje më të madhe nga ekspertët e Shteteve Anëtare.	2019-20
1.3. Rritja e monitorimit të reformave nëpërmjet misioneve më sistematike, <b>misioneve të vlerësimit kolegjial të bazuara në raste.</b>	2018-19
1.4. Futja e <b>monitorimit të gjykimeve</b> në fushën e korrupsionit të rëndë dhe krimit të organizuar.	2019-20
1.5. Puna drejt <b>matjes më të mirë të rezultateve në reformën e drejtësisë.</b>	2018-19
1.6. Puna drejt <b>përdorimit më të mirë të kushtëyimit në negociatat e aderimit</b> , në veçanti duke siguruar rezultate konkrete në reformën gjyqësore dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar arrihen përpara se bisedimet teknike mbi kapitujt e tjerë të mund të mbyllen përkohësisht.	2018
1.7 Shpalosja e mbështetjes për Ballkanin Perëndimor përmes <b>Ndihmës Evropiane për Demokraci (European Endowment for Democracy)</b> në fushën e medias së pavarur dhe pluraliste dhe shoqërisë civile.	2018-19
<b>2. Përforcimi i angazhimit në siguri dhe migracion</b>	
2.1. Avancimi i punës së përbashkët <b>kundër terrorizmit</b> dhe në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Duhet krijuar ose forcuar koordinorët kombëtarë dhe zyrat për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe duhet të krijohet një rrjet rajonal i koordinorëve kombëtarë, me mbështetjen e Rrjetit të BE-së për Sensibilizim ndaj Radikalizimit dhe ekspertit rajonal të BE-së kundër terrorizmit. Do të përpunohen planet e përbashkëta të veprimit kundër terrorizmit.	2018-19
2.2. Rritja e konsiderueshme e <b>bashkëpunimit operacional</b> , duke përfshirë bashkëpunimin me agjencitë e BE-së në luftën kundër <b>krimit të organizuar</b> ndërkombëtar, në veçanti ndaj armëve të zjarrit, trafikimit të drogës, kontrabandimit të emigrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore.	2018-19
2.3. Sistematizimi i <b>zyrtarëve ndërlidhës të Europolit</b> në tërë rajonin.	2019
2.4. Nxitja e finalizimit të <b>marrëveshjeve të bashkëpunimit me Eurojust.</b>	2019-20
2.5. Promovimi i mëtejshëm i <b>Ekipeve të Përbashkëta Hetimore</b> që inkuadrojnë Ballkanin Perëndimor dhe Shtetet Anëtare të BE-së. Kjo duhet të kërkojë një përfshirje aktive të Eurojust dhe Europol, në përputhje me mandatet e tyre përkatëse.	2018-19
2.6. Zgjerimi i <b>Ciklit të Politikave të BE-së mbi krimin e organizuar</b> deri në masën e mundshme për të përfshirë Ballkanin Perëndimor në aktivitetet e saj operacionale. Ballkani Perëndimor do të ftohet të marrë pjesë në Platforma të Veçanta Multi-disiplinore Evropiane kundër projekteve të Kërcënimeve Kriminale dhe në takimet e Komisionit të Përhershëm për Bashkëpunim Operacional për Sigurinë e Brendshme, përfshirë ato të mbajtura së bashku me Komitetin për Siguri Politike në baza ad-hoc kur diskutohen projektet.	2018
2.7. Rritja e mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve në fushën e <b>sigurisë kibernetike</b> dhe luftën kundër <b>krimit kibernetik</b> , duke përfshirë bashkëpunimin me Grupin Evropian të Trajnimeve dhe Edukimit mbi Krimin Kibernetik, me synimin për pjesëmarrje në Agjencinë Evropiane për Sigurinë e Rrjeteve dhe Informacionit.	2018-19
2.8. Rritja e bashkëpunimit për <b>migracionin dhe menaxhimin e kufijve</b> , forcimi i rrjedhës së informacionit strategjik dhe taktik në parandalimin dhe luftën kundër <b>migracionit të parregullt</b> dhe kthimin e shtetasve të vendeve të treta, veçanërisht nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të statusit me Agjencinë Evropiane të Rojave Kufitare dhe Bregdetare.	2018-19
2.9. Zgjerimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërmjet <b>zyrtarëve ndërlidhës</b> të vendosur nga Shtetet Anëtare të BE-së (Agjencia Evropiane e Rojave Kufitare dhe Bregdetare) dhe autoritetet kompetente të Ballkanit Perëndimor	2018
2.10. Krijimi i <b>qendrave koordinuese kombëtare për kontrollin e kufijve</b> në vendet e Ballkanit Perëndimor duke i lidhur ato nëpërmjet një rrjeti rajonal me qendrat kombëtare koordinuese për shkëmbimin e informacionit në Shtetet Anëtare fqinje.	2019

2.11. Me qëllim të ndjekjes së veprimeve të ndryshme që duhet të ndërmerren nga agjencitë e BE-së, krijimi i një <b>Task Force ndërinstitucionale të BE-së</b> të koordinuar nga Komisioni që përfshin Europolin, Agjencinë e Rojave Kufitare dhe Bregdetare, Eurojust, Qendrën Evropiane të Monitorimit për Drogat dhe varësinë nga droga, Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnim të Zbatimit të Ligjit.	2019
2.12. Vlerësimi i Planit të Veprimit 2015-2019 për trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit për të përgatitur rinovimin e tij në vitin 2019 për të adresuar në mënyrë më efektive furnizimin e <b>armëve të paligjshme dhe të stoqeve të mëdha të armëve</b> .	2018-19
2.13. <b>Dialogu i Strukturuar i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë/Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes</b> i zgjeruar dhe i thelluar me Ballkanin Perëndimor, me një kontribut më të madh në misionet dhe operacionet e BE-së në mbarë botën.	2018
2.14. Zhvillimi i mëtejshëm i pjesëmarrjes në veprimet lidhur me kërcënimet hibride, inteligjencën, çështjet e hapësirës dhe reformës së sektorit të mbrojtjes dhe të sigurisë.	2018
<b>3. Mbështetja e zhvillimit socio-ekonomik</b>	
3.1. <b>Korniza Investive e Ballkanit Perëndimor</b> do të zgjerohet për të tërhequr dhe koordinuar më tej investimet dypalëshe të donatorëve dhe të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare.	2019
3.2 Shtytja e konsiderueshme në ofrimin e <b>garancive</b> tek Korniza Investive e Ballkanit Perëndimor <b>për të shtuar investimet private</b> .	2019
3.3. Forcimi i masave për të mbështetur <b>zhvillimin e sektorit privat</b> , duke përfshirë një skemë që mbështet startup-ët në të gjithë rajonin dhe mbështetja e përpjekjeve që synojnë specializimin e mençur.	2019
3.4. Rritja e qasjes në financa dhe shfrytëzimi i potencialit të rritjes së <b>ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme</b> .	2018
3.5. Integrimi i mëtejshëm i Ballkanit Perëndimor në rrjetet ekzistuese të njohurisë të BE-së dhe mbështetja e ndërtimit të kapaciteteve <b>kërkimore dhe inovative</b> për një pjesëmarrje efektive në Programet Kornizë të BE-së.	2018
3.6. Mobilizimi i ekspertizës së BE-së për të mbështetur implementimin e <b>Zonës Ekonomike Rajonale</b> .	2018
3.7. <b>Lehtësimi i tregtisë</b> ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe në rajon, duke përfshirë zhvillimin e programeve të njohjes reciproke në bazë të Marrëveshjes së Zonës së Tregëtisë së Lirë të Evropës Qendrore dhe Zonës Ekonomike Rajonale (p.sh. Operatorët e Autorizuar Ekonomik).	2018
3.8 Ndihma e mëtejme ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë në procesin e aderimit në <b>Organizatën Botërore të Tregtisë</b> .	2018
3.9. Rritja e ndihmës për Ballkanin Perëndimor përmes dialogëve të përforcuar dhe aktiviteteve informuese në funksion të sigurimit të konvergencës së kontrolleve të <b>eksportit të mallrave për përdorim të dyfishtë</b> .	2018
3.10. Forcimi i mëtejshëm i ushtrimit të <b>programit të reformave ekonomike</b> duke e përafëruar atë me Semestrin Evropian ekzistues për Shtetet Anëtare të BE-së, duke forcuar asistencën teknike dhe duke integruar më tej prioritetet e programeve të reformave ekonomike dhe udhëzimet e politikave ministrore në programimin e Instrumentit për Asistencë të Para-antarësimin.	2018-19
3.11. Rritja e përqendrimit në <b>punësim dhe reforma sociale</b> nëpërmjet një monitorimi më të gjerë të politikave përkatëse dhe krijimi i një takimi ministror vjetor të BE - Ballkani Perëndimor mbi këto çështje që do të futen në programet e reformave ekonomike.	2019
3.12. Ofrimi më i gjerë i ndihmës financiare në <b>fushën sociale</b> në Ballkanin Perëndimor, përfshirë shëndetësinë.	2019-20
3.13 Rritja e mbështetjes në arsim, posaçërisht lansimi i një pilot projekti për mobilitet në <b>arsimin dhe aftësimin profesional</b> .	2019
3.14. <b>Financimi i dyfishtë</b> nën programin Erasmus+.	2019-20
<b>4. Rritja e lidhshmërisë</b>	
4.1. Mbështetja e shfrytëzimit të shtuar të mundësive në kuadër të <b>Istrumentit të Lidhjes Evropiane</b> në Ballkanin Perëndimor, në përputhje edhe me objektivat përkatëse të strategjive makro-rajonale të BE-së.	2018
4.2. Shtirja e <b>Unionit Energjetik</b> të BE-së në Ballkanin Perëndimor: siguria energjetike, hapja e tregjeve dhe tranzicioni i energjisë - duke përfshirë efikasitetin e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme.	2019-20

4.3. Mbështetja për ngritjen e kapaciteteve dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së autoriteteve dhe organizatave të Ballkanit Perëndimor në punën e rrjetit të <b>rregullatorëve të energjisë dhe operatorëve të sistemit të transmissioinit dhe shpërndarjes</b> , veçanërisht Agjencisë për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë dhe Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmissioinit.	2018- 19
4.4. Puna për kompletimin e <b>Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike</b> në Ballkanin Perëndimor dhe për t'u siguruar që tregu i Ballkanit Perëndimor të jetë i integruar në Tregun e Brendshëm të Energjisë së BE-së.	2018-19
4.5 Mbështetja e mëtejshme për krijimin e një hapësire të vetme rregullatore dhe një procesi efektiv të reformës së tregut të energjisë në kuadër të <b>Traktatit të Komunitetit të Energjisë</b> .	2018
4.6. Mbështetja për zbatimin e <b>Traktatit të Komunitetit të Transportit</b> dhe funksionimin e plotë të sekretariatit të tij.	2018-19
4.7. Vazhdimi i inkurajimit të pjesëmarrjes së Ballkanit Perëndimor në forumet e ndryshme të transportit dhe takimet e <b>Komitetit të Rrjetit Trans-Evropian për Transport</b> .	2019
4.8. Mbështetja për rritjen e konkurrueshmërisë përmes masave të zgjeruara për të <b>hequr pengesat në kufij</b> , veçanërisht për pikëkalimet kufitare të integruara të rrugëve dhe hekurudhave.	2018-19
4.9. Mbështetja për një <b>strategji të re hekurudhore</b> për të sjellë Ballkanin Perëndimor në rrjetin dhe tregun kryesor të BE-së përmes integritimit progresiv në Korridoret Kryesore të BE-së - Orient/Mesdhe Lindor dhe Mesdhe.	2018
4.10. Shqyrtimi i mundësive për të lejuar pjesëmarrjen e Ballkanit Perëndimor në <b>agjencitë evropiane të transportit</b> .	2018
4.11. Mbështetja e krijimit të një <b>strategjie të re të sigurisë rrugore</b> duke përfshirë punën për të zvogëluar fatalitetet rrugore duke hequr pikat e zeza të sigurisë rrugore.	2018-19
<b>5. Një Agjendë digjitale për Ballkanin Perëndimor</b>	
5.1. Lansimi i një <b>Agjende Digjitale për Ballkanin Perëndimor</b> , duke përfshirë një udhëzues për të lehtësuar uljen e kostos së roamingut.	2018
5.2. Mbështetja për <b>instalimin e teknologjisë brezgjere (broadband)</b> në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë integrimin në rrjetin e Broadband Competence Office.	2018-19
5.3. Mbështetja e zhvillimit të <b>e-Qeverisjes, e-Prokurimit, e-Shëndetësisë</b> dhe shkathtësive digjitale në Ballkanin Perëndimor.	2018-19
5.4. Mbështetja e ndërtimit të kapaciteteve në <b>besimin dhe sigurinë digjitale</b> , paralelisht me përpjekjet për të rritur digjitalizimin e industrive.	2018-19
5.5. Rritja e mbështetjes për miratimin, implementimin dhe zbatimin e <i>acquis</i> në fushën e <b>Tregut të vetëm Digjital</b> .	2018-19
<b>6. Mbështetja e pajtimit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore</b>	
6.1. Mbështetja e iniciativave për të nxitur pajtimin dhe <b>drejtësinë tranzicionale</b> , siç është themelimi i Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë (KOMRA).	2018-19
6.2 Mbështetja në <b>luftën kundër pandëshkueshmërisë</b> nëpërmjet mbështetjes së Mekanizmit për Tribunalet Penale Ndërkombëtare, si për të thelluar bashkëpunimin midis prokurorëve vendas dhe për të informuar publikun, edhe për Dhomat e Specializuara të Kosovës.	2018-19
6.3 Puna drejt një zgjidhjeje rajonale për zgjidhjen e çështjes së <b>personave të zhdukur dhe minave tokësore</b> .	2018-19
6.4. Mbështetja e mëtejshme për iniciativat e pajtimit, duke përfshirë zgjerimin e fushëveprimit dhe qasshmërinë e <b>Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor</b> dhe futjen e një skeme mobiliteti brenda rajonit.	2018-19
6.5. Rritja e bashkëpunimit <b>në kulturë dhe sport</b> , duke përfshirë punën për të mbrojtur trashëgiminë kulturore të Ballkanit Perëndimor, për të luftuar trafikun e paligjshëm të të mirave kulturore dhe për të promovuar industrinë e tij kulturore dhe krijuese, duke përfshirë pjesëmarrjen në programin " <b>Evropa Kreative</b> ".	2018
6.6. Vendet e Ballkanit Perëndimor do të jenë plotësisht të lidhura me Vitin Evropian të Trashëgimisë Kulturore dhe do të përfshihen në të gjitha ngjarjet dhe iniciativat relevante. Lansimi i një <b>Rruge të Trashëgimisë BE - Ballkan Perëndimor</b> , që përfshin një sërë ngjarjesh të festimit të trashëgimisë kulturore në të gjitha format.	2018